



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA THEMELORE PEJË-DEGA NË ISTOG**  
OSNOVNI SUD PEC - OGRANAK ISTOK BASIC COURT OF PEJA-BRANCH IN ISTOG

---

**P.nr.110/20**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE PEJE DEGA NË ISTOG – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM**, sipas Gjyqtarit Arben Mustafaj, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Hale Ahmetaj në lëndën penale kundër të pandehurit H H nga f.sh. ... K. Istog, i akuzuar për veprë “vjedhje pylli” nga neni 349 par.1 te KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore ne Peje – Departamenti i Përgjithshëm, PP/IInr.587/2020 të datës 29.05.2020 në seancën publike të shqyrtimit fillestar të mbajtur me dt.**01.07.2020**, në praninë e Prokurorit te Shtetit Suada Hamza , të pandehurit H H, Gjykata të njëjtën ditë publikisht mori dhe shpalli, ndërsa me dt.06.07.2020 përpiloje këtë:

**A K T G J Y K I M**

I pandehuri **H H**, i lindur me ... ne f.sh. ... K. Istog, ku edhe banon, i biri i SH dhe nënës F. e gjinisë Z., i martuar, babai i katër fëmijëve, ka të kryer katër klasë te shkollën fillore, i gjendjes se dobët ekonomike, i identifikuar ne bazë të letërnjoftimit me nr.... Shqiptar, Shtetas i Republikës se Kosovës, i dënuar edhe ma parë nga Gjykata, gjendet në liri.

**ËSHTË FAJTOR**

**Për shkak se:**

Me datë, 16.05.2020 rreth orës 11:00 ne ... K Istog, me qëllim te vjedhjes pret trungje ne pyll te cilat tejkalojnë dy metra kub dhe atë ne sasi prej 3.00 m<sup>3</sup> ne dem te Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi të KK. Istog, ne atë mënyrë qe, i pandehuri shkon ne vendin e lartcekur dhe me sharre motorike pret dy trungje ne gjatësi rreth 12 m te ahut me vëllim prej 3.00 m<sup>3</sup> dhe te njëjtat fillon t'i bart me traktorin e tij, kur edhe hetohet nga Policia e Kosovës.

- me çka ka kryer veprën penale “vjedhje Pyllit” nga neni 349 par.1 te KPRK-së

Gjykata duke vendosur në kuptim të nenit 7,8,9,10,17,21,38,40,43,69,70, nenit 349, par.1 të KPRK-së, dhe nenit 115 par.2 pika 2.2nenit dhe 116 par.1, nenit 359, 360, 361, 365, 366, 450, 463 të KPPRK-së,:

E Gjykon me:

## **DËNIM ME GJOBË**

**Ashtu që:**

**1.**Të pandehurit **H H**, Gjykata i përcakton dënimin me gjobë në shumen prej **300( treqind ) euro** të cilin dënim i pandehuri duhet ta paguaj në afatin prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

**2.** Nëse i akuzuari nuk e paguan gjobën e lartë shqiptuar me kohë të përcaktuar, e njëjta gjobë do të zëvendësohet më dënim me burg konform nenit 43 par 3 të KPRK-së, ku **20(njëzet)** euro të gjobës do ti llogaritet n një ditë burgim të mbajtur.

**3.** I pandehuri obligohet që në emër të paushallit gjyqësore te paguaj shumen prej **20 ( njëzet ) euro**, si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej **30 ( tredhjet ) euro** në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

**4.**E dëmtuara DBPH- zyra në Istog, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.

## **DËNIM PLOTËSUES**

**5.** Gjykata duke vepruar komfor nenit 69 par.1 të KPK-së, dhe nenit 115 par.2 nen par.2.2 të KPPK-së, **pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi URDHEROHET konfiskimi i përhershëm** i trungjeve të ahut, në sasi prej 3.00 m<sup>3</sup>, të cilat përbëjnë dobi pasurore të fituar me vepër penale dhe të njëjtat i kthehen në administrim të dëmtuarës Drejtoratit për Bujqesi Pylltari dhe Hidroekonomi pranë KK Istog.

**6.** Konform nenit 116 par 1 të KPPRK-së, **pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi, të** pandehurit **H H**, i kthehet sendi i sekuestruar përkohësisht dhe atë: Një traktori i tipit “Massey Ferguson 595” ngjyrë e kuqe pa targa, pasi qe nuk ka bazë ligjore për konfiskim të përhershëm të tije.

## **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore ne Peje - Departamenti i përgjithshëm, pranë kësaj gjykate ka ngritë aktakuzën, me PP./II nr.587/2020 të datës 29.05.2020, ndaj te **H H** nga f.sh. U. K. Istog, duke e akuzuar për vepër “vjedhje pylli” nga neni 349 par.1 te KPRK-së.

Gjykata ka mbajtur shqyrtimin fillestar më datë 01.07.2020 ku kanë prezantuar Prokurori i shtetit, Suada Hamza, dhe i pandehuri **H H**.

Pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit, i pandehuri deklaroj se ka kuptuar aktakuzën, dhe e pranoj fajësinë për veprën penale për te cilën akuzohem, me vjen keq për rastin qe me ka ndodhur, është hera e parë qe kam renë ndesh me ligjin,

I pandehuri deklaron: se e pranoj fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohem, me vjen keq për rastin që me ka ndodhur, ju premtoj se në të ardhmen nuk do të bije ndesh me ligjin, kërkoj nga gjykata që të më mundësohet kthimi i traktorit pasi që e kam të vetmin mjet për jetës, me të cilin e punoj token ku i mbaj 6 anëtarë të familjes dhe po ashtu me të njëjtin i transportoj edhe lopët në bjeshkë dhe e ka mjet të domosdoshëm për mbijetesë.

Gjykata kërkon mendimin e prokurorit të shtetit, lidhur me pranimin e fajësisë së të pandehurit. Prokurori i shtetit deklaron: se pajtohet me pranimin e fajësisë, i cili pranim ka mbështetje në provat që gjenden në shkresat e lëndës, dhe është bere komfor dispozitave ligjore, i propozoj gjykatës që të njëjtin të shpall fajtor të dënoj sipas ligjit dhe të obligoj në paguarjen e shpenzimeve të procedurës penale dhe krahas dënimit kryesor propozoj edhe dënimin plotësues si në aktakuzë, që të njëjti të konfiskohet traktori dhe masa drusore, të cilat janë të sekuestruara përkohësisht dhe me rastin e marrjes së vendimit mbi dënim pranimin e fajësisë, të marr si rrethanë lehtësuese.

Pas deklarimit të pandehurit se e pranon fajësinë, mendimit të prokurorit se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit. Gjykata konstatoj se i pandehuri pranon fajësinë në mënyrë vullnetare, pa asnjë presion. I pandehuri është i vetëdijshëm për pasojat dhe përparësitë e pranimin të fajësisë, si dhe të gjitha kërkesat nga neni 248 par.1 të KPPRK-së janë përmbushur. Ashtu që Gjykata me aktvendim në procesverbal aprovon deklarimin për pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.

Me faktet e ofruara në shkresat e lëndës, si dhe pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit H H, është vërtetuar se i njëjti me datë 16.05.2020 rreth orës 11:00 në ... K Istog, me qëllim të vjedhjes pret trungje në pyll të cilat tejkalojnë dy metra kub dhe atë në sasi prej 3.00 m<sup>3</sup> në dem të Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi të KK. Istog, në atë mënyrë që, i pandehuri shkon në vendin e lartcekur dhe me sharre motorike pret dy trungje në gjatësi rreth 12 m të ahut me vëllim prej 3.00 m<sup>3</sup> dhe të njëjtat fillon t'i bart me traktorin e tij, kur edhe hetohet nga Policia e Kosovës.

Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të aktgjykimit, pa dyshim rrjedh se në veprimet e të pandehurit qëndrojnë të gjitha elementet veprën penale "vjedhje Pyllit" nga neni 349 par.1 të KPRK-së

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se të i pandehuri ka ekzistuar dashja që veprën penale ta kryen në mënyrë të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit pasi që ka qenë i vetëdijshëm për veprën e kryer dhe e ka dëshiruar kryerjen e saj.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqit rrethanat të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësinë penale të pandehurit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës, për veprën penale më të cilën është akuzuar.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së Kështu si rrethanat lehtësuese për të pandehurin gjykata gjeti se i pandehuri ka treguar sjellje korrekte në gjykatë, e për me tepër ka pranuar fajësinë dhe ka shpreh keqardhje për veprën që e ka kryer, duke premtuar se në

të ardhmen nuk do merret me këso vepra penale, të gjitha këto rrethana kjo gjykatë i ka pranuar si rrethana lehtësuese në dobi të të pandehurit.

Rrethanë rënduese gjykata gjeti faktin se i pandehuri edhe me parë ka qenë i dënuar nga kjo Gjykatë sipas aktgjykimit të plotfuqishëm me Pnr.117/16 i dt.24.01.2017, për vepër penale nga neni 188 par.1 pika 1.4 të KPRK-së, është dënuar me kusht 6 muaj për një vite.

Gjykata ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar të pandehurit është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë. Gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit në pengimin e të pandehurit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen, por ai do të ndikoj edhe si preventivë e përgjithshme për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale në përputhje me nenin 38 të KPRK-së.

Duke u bazuar ne nenin 450 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së, gjykata ka përcaktuar paushallin gjyqësorë si në dispozitiv të aktgjykimit.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë, komfor nenit 39 par.3 nën par 3.1 të Ligjit nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi konfiskimin e përhershëm të trungjeve është marrë komfor nenit 69 par.1 të KPK-së, dhe nenit 115 par.2 nën par.2.2 të KPPK-së.

Vendimi për kthimin e sendeve të konfiskuara përkohësisht është marrë konform nenit 116 par 1 të KPPRK-së.

Vendimi mbi udhëzimin e te dëmtuarës ne kontest civil është marrë konform nenit 463 par. 1. dhe 2. te KPPK-ës.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe me zbatimin e nenit 370 të KPPRK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË DEGA ISTOG**  
**DEPARTAMENTI I PERGJITHSHEM PENAL**  
**P.nr.110/20 më datë 01.07.2020**

**Sekretaria juridike**

**Hale Ahmetaj**

**Gjyqtari Gjykues**

**Arben Mustafaj**

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Palët që në afatin ligjor kanë paralajmëruar ankesë kanë të drejtë që ankesën ta bëjnë në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së aktgjykimit. Ankesa i dërgohet

Gjykatës se Apelit ne Prishtine e përmes kësaj Gjykate